

VENDIM
Nr. 272, datë 3.4.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN PËR PËRDORIM
ME KONCESION TË BURIMIT UJOR SASAJ” DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË “BLUE EYE
ONE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, dhe 23 pika 3 shkronja “b”, të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien për përdorim me koncesion të burimit ujor “Sasaj”, është Ministra e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
2. Koncesioni do të jetë i formës BOT (ndërtim-shfrytëzim dhe transferim në pronësi të shtetit).
3. Miratimin e bonusit prej 8,5% të pikave, për rezultatin teknik, financiar dhe mjedisor, në procedurën përzgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Blue eye one”.
4. Ngarkohet Ministra e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha